

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar	28.08.2020		
Nj. Org.	Numr	Shtoje	Vlera
01 -	060 -	55526	



Republika e Kosovës  
Komuna e Drenasit  
Zyra e Kryetarit të Komunës



### Raport i dëgjimit buxhetor publik për vitet 2021-2023

Dëgjimi publik për buxhetin për vitin 2021-2023 është mbajtur me datë 19.08.2020 në bashkësinë lokale të Dobroshecit, Bashkësinë Lokale në Terstenik, Bashkësia Lokale në Baicë, Bashkësia Lokale në Arllat, Bashkësia Lokale në Komoran dhe në Drenas.

Mbledhjen e hapi Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun, Bekim Dobra, duke filluar në ora 10:30, ku të pranishëm ishin: Nënkyetari i Komunës, Nazmi Hasi, Drejtori për Infrastrukturë Lokale, Endrit Gllareva, Drejtoresha për Planifikim, Flutura Avdiu, Drejtoresha për Shërbime Publike, Lumnije Krapi, Drejtori për Buxhet dhe Financa, Shyqiri Bublaku, Drejtoresha për Zhvillim Ekonomik, Egzona Jetullahi, Drejtori për Arsim, Muhamet Gjoka, U.D e Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Arberije Gllareva, administratorë të vendbanimeve nga bashkësia e Dobroshecit dhe përfaqësues të lagjeve.

Të pranishmit janë pajisur me draft-listën e investimeve kapitale për vendbanimin e tyre dhe janë njoftuar për buxhetin e ndarë për vitet në vazhdim si dhe janë njoftuar me pikat e rëndit të ditës: Informatë e përgjithshme lidhur me buxhetin komunal 2021-2023; Lista e investimeve kapitale në Bashkësinë e Dobroshecit dhe Kërkesat e banorëve.

#### Kërkesat e qytetarëve:

**Albert Nika – Administrator i fshatit Gllanasellë** – Në fshatin tonë kanë mbetur edhe 400 metra kanalizim, ndërsa kemi nevojë për ndriçim publik të disa rrugëve, sidomos ajo që është më e frekuentuara nga shkolla dhe ambulanta e fshatit. Edhe rrjeti i ujësjellësit në fshat nuk është funksional dhe është mirë që Komuna të mendoj për këtë projekt dhe të planifikoj mjete për të rregulluar sepse me ujë të pijshëm e kemi gjendjen jo mirë. Pasi që i kam paraqitur kërkesat edhe me shkrim dhe në takimin e fundit, për të mos ju marr kohë të tjerëve, nuk isha zgjatur më shumë në këtë debat.

**Për këto kërkesa u njoftua Drejtori për Infrastrukturë, z. Endrit Gllareva i cili e njoftoi me projektet e deritanishme lidhur me kanalizim dhe ujësjellës dhe për përfshirjen e tyre në KAB.** Këto kërkesa edhe janë regjistruar si audio dhe janë përfshirë në procesverbal.

**Mehmet Kurrumeli – përfaqësues i lagjes Kurrumeli në fshatin Gllanasellë** paraqiti kërkesat e lagjes për ujë të pijshëm.

Fshati është i lidhur me gypin e shkollës, prandaj kërkojë që të rregullohet rrjeti i ujësjellësit që është problem që 15 vite kur është ndërtuar me vetëfinancim të banorëve të fshatit. Gypi është dëmtuar dhe besoj që tani është edhe jo funksional. Kemi nevojë edhe për trotuar deri të shkolla, sepse ajo pjesë është shumë e frekuentuar nga nxënësit dhe po rrezikohen.

Lidhur me këtë kërkesë, u përgjigj **Drejtori i Financave, Shyqiri Bublaku** i cili tha se lënda e ujësjellësit është në hetuesi, për shkak të problemeve që ka pasur nga e kaluara që projekti nuk është kryer siç duhet dhe deri në përfundimin e procedurave gjyqësore, nuk po mundemi të ekzekutojmë projektin, ndonëse mjetet janë ndarë dhe janë në dispozicion për t'u finalizuar projekti që i lidh 22 vendbanime për t'i furnizuar me rrjetin e ujësjellësit.

**Drejtoresha e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, Lumnije Krapi** – jemi në dijeni lidhur me këtë gyp të ujësjellësit në fshatin Gllanasellë, kemi biseduar me drejtorin e ujësjellësit në Drenas dhe na kanë njoftuar se do të merren me këtë çështje për të rregulluar.

**Hysen Avdyli – Administrator i fshatit Likoshan** – Kemi 2 rrugica nga 250 metra për asfaltim e po ashtu kemi edhe për 200 metra kanalizim. Për ujë po e dini edhe ju që gjendja nuk është aspak e mirë dhe kemi nevojë, është vendosur gypi i ujësjellësit, por ai nuk është funksional. Kemi nevojë edhe për ndriçim të një rruge ku është më e frekuentuar dhe që ju kemi bërë kërkesë edhe përmes shkrimit.

Për këto dy kërkesa u njoftuan drejtoritë përkatëse dhe njoftuan administratorin se këto çështje tashmë janë pjesë e projekteve që janë duke u realizuar.

**Arsim Avdyli – nga fshati Dobroshec** – mungesa e kanalizimeve në lagjen Ademi, por edhe në lagjen Avdypi e Prenku nuk është përfunduar dhe kemi probleme me rrjetet e kanalizimeve. Shkolla e fshatit është e kyçur, por ka mbetur vetëm ambulanta e fshatit të kyçet në rrjetin e kanalizimit pasi që janë afér njëra tjetrës dhe me pak metra rregullohet edhe problemi i kanalizimit të këtij objekti. Shkolla e fshatit është në gjendje jo të mirë, është shkolla e parë në Drenas dhe ky objekt ka nevojë për hapësira me të madhe, për kabinete e salla të tjera, kësaj shkolle i mungon edhe fusha sportive.

Lidhur me çështjen e kanalizimit, administratori u njoftua me masat që janë ndërmarrë deri tani nga komuna.

**Esat Fejza – përfaqësues i lagjes Fejza në fshatin Dobroshec** – unaza e fshatit është mirë të jetë prioritet për asfaltim, po ashtu kemi nevojë edhe për ndriçim të rrugëve në lagjen tonë.

**Lidhur me këtë pyetje, Drejtori i Infrastrukturës Lokale, Endrit Gllareva** e njoftoi se ne e kemi filluar ju e dini asfaltimin e unazës së asaj pjesë që po e përmendni, por kemi pasur disa probleme pronësore.

**Ndërsa për ndriçimin, Drejtoresha e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, Lumnije Krapi** e njoftoi për kodin e bashkëfinancimit të projekteve dhe mundeni edhe vetë lagjet me u organizu për rregullimin e tyre, ndërsa faturat e shpenzimeve pastaj i bartën komunës. Kemi disa lagje në fshatra që janë irregulluar.

**Qerim Bërbatovci – Administrator i fshatit Godanc** – kemi nevojë për asfaltimin e rrugës Godanc-Gllanasellë, vitin e kaluar ka qenë për t'u kryer gjatë këtij viti, kisha pas dëshirë me e ditë a është në planifikim për këtë vit, apo duhet planifikuar për vitin e ardhshëm. Po ashtu në fshatin tonë kemi kanë mbetur edhe disa lagje pa kanalizim, kemi nevojë edhe për projektin me ujë të pijes, nuk është funksional rrjeti i ujësjellësit.

**Drejtori i Infrastrukturës Lokale, Endrit Gllareva** – rruga Gllanasellë-Godanc do të përfundoj gjatë këtij viti, ndërsa rrjeti i kanalizimit është i planifikuar për vitin e ardhshëm.

**Olivera Isufi, mësimdhënëse në shkollën e fshatit Dobroshec** – kisha pas dëshirë me e ditë lidhur me shujtat e mësimdhënësve, a është planifikuar diçka lidhur me pagesat për vitin e ardhshëm.

**Drejtori për Buxhet e Financa, Shyqeri Bublaku** – nuk është e mundur të hyjë në buxhet një kod i tillë ende kjo çështje si kategori. Nënshkrimi i kontratës kolektive për shujta është bërë pa një planifikim dhe komunave po ju del problem në pagesat përmes formës përmbarimore.

**Drejtori i Arsimit, Muhamet Gjoka** – shujta është e drejtë që ju takon, por kur është nënshkruar kontrata, nuk është menduar mirë masa buxhetore, prandaj nuk mund të irregullohet ende, sepse ka një kosto shumë të madhe.

Dëgjimi buxhetor vazhdoi në Bashkësinë Lokale të Terstenikut në fshatrat Tërstenik I dhe II, Vërboc, Polluzhë dhe Shtuticë.

**Drejtori për Buxhet e Financa, Shyqiri Bublaku** – ka informuar të pranishmit lidhur me draftin e buxhetit të ndarë nga Komuna e Drenasit për vitin 2021 dhe vitet 2022-2023.

### **Kërkesat e qytetarëve;**

Nazmi Mulaj, përfaqësues i lagjes Mulaj në Tërstenik II – kemi problem me kanalizim në lagjen tonë, po ashtu në lagjen te Selimt janë rreth 600 metra për asfaltim që janë shumë të rëndësishme. Kanalizimi është mbi tokë dhe po shkakton probleme të mëdha, nuk kemi ende diçka konkrete lidhur me këtë kanalizim, ky kanalizim po i dëmton edhe puset private të banorëve.

Drejtori për Inrastrukturë Lokale, Endrit Gllareva – rrjeti i kanalizimit në lagjen Mulaj përfundon gjatë këtij viti, një pjesë edhe e rrugës po ashtu, por pjesa tjetër e lagjeve është planifikuar për vitin e ardhshëm.

Nazmi Mulaj – po ashtu edhe lagja Munisht dhe lagja Franca kanë nevojë për asfaltim të rrugës se e kanë në gjendje shumë të keqe.

Ilmi Kastrati, nënkyetar i fshatit Polluzhë – në lagjen Kastrati kemi problem për mbikalimin, na kanë thënë se do të kryhet gjatë këtij viti, por po presim që të behët një zgjidhje. Kemi nevojë për rregullimin e trotuareve ne një pjesë të rrugës ku ka frekuentim, po ashtu kemi probleme me ujë për pije nuk ka fare në fshat, pastaj po ashtu edhe me rrjetin e kanalizimeve, ku edhe oborri i shkollës është mbushur me ujë nga kanalizimet.

**Drejtori për Infrastrukturë Lokale, Endrit Gllareva** – do të behët mbikalimi sepse kemi bërë kërkesë në Ministri dhe na kanë njoftuar se do të kryhet. Ndërsa në rrjetin e kanalizimit është duke u punuar me kolektorë që përfshihet komplet fshati Polluzhë.

**Drejtoresha e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, Lumnije Krapi** – sa i përket kanalizimeve, ne i bëjmë ndërhyrjet në ato vende ku ka bllokime për debllokimin e tyre, edhe në fshatin Polluzhë kemi bërë disa herë intervenime, por besoj që këtë vit me rregullimin e kolektorëve, do të eliminohet ky problem.

Rexhep Istogu, administrator i fshatit Polluzhë – të lagja Istogu, gropat septike duhet të mbulohen dhe të mos mbesin në atë gjendje sepse po rrezikohen banorët. Shkolla është në gjendje jo të mirë, po ashtu edhe ujësjellësi është në gjendje të keqe dhe nuk kemi fare dhe kemi si prioritet të rregullohet.

**Nënkyetari i Komunës, Nazmi Hasi** – sa i përket rrjetit të ujësjellësit, procedurat e këtij projekti janë në hetime për shkak të defekteve të viteve paraprake dhe pa përfunduar ato, nuk mund të fillojmë me realizimin e projektit, me përfundimin e tyre, ne do të fillojmë në realizimin e projektit i cili do të përfshinë 22 vendbanime.

Valdet Dvorani, përfaqësues i lagjes Dvorani në fshatin Tërstenik I – rreth rrjetit të kanalizimit e di që në fshat ka përfunduar rrëth 90 për qind të tij, por në lagjen Dvorani nuk janë lidhur lagja dhe ka mbetur pa u përfshirë në këtë rrjet të kanalizimit. Kemi edhe disa rrugë në fshat që nuk janë kryer me asfaltim dhe janë shumë të nevojshme sepse kanë kryje direkt në autostradë. Të rruga kryesore nuk është planifikuar të behët një nënkalim dhe jemi tejet të rrezikuar, sidomos fëmijët që kanë vajte-ardhjen në shkollë.

**Drejtori i Infrastrukturës Lokale, Endrit Gllareva** – sa i përket trotuarit e kam bërë kërkesën në Ministri për pëlqim, momentin që kthehet pëlqimi do të shtrohet trotuari.

**Avni Gjoka, përfaqësues i lagjes Gjoka, Tërstenik II** – ju përgëzoj për punën e bërë deri më tani, por kemi probleme me rrjetin e kanalizimit në lagjen Gjoka, janë disa metra të pa kryera, e po ashtu rrjeti i kanalizimit është në gjendje të keqe edhe në lagjet tjera, prandaj kërkoj që për vitin e ardhshëm të jetë prioritet përfundimi i rrjetit të kanalizimit në fshatin tonë.

**Bashkësia Lokale e Baicës** (Abri, Tërdec, Baicë, Krajkovë dhe Damanek) më datë. 19.08.2020 ora 14:54 në SHFMU “Migjeni” Baicë.

**Drejtori për Buxhet e Financa, Shyqiri Bublaku** – ka informuar të pranishmit lidhur me draftin e buxhetit të ndarë nga Komuna e Drenasit për vitin 2021 dhe vitet 2022-2023.

**Kërkesat e qytetarëve;**

**Mehmet Zariqi, përfaqësues i lagjes Zariqi në fshatin Baicë** – rruga në lagjen Zariqi nuk është e përfshirë në këto listat që na i keni sjell, një familje ka mbetur pa u përfshi në rrjetin e kanalizimit, gjatësia është mbi 200 metra.

**Samedin Kiqina, administrator i fshatit Baicë** – ne si fshat kemi probleme me kanalizimin në disa lagje. Lagja Leku, Kiqina, Binaku nuk janë ende të kyçura në rrjetin e kanalizimit. Kemi në gjendje jo të mirë një familje mbi shkollë që ka mbetur pa u përfshi në rrjetin e kanalizimit, është veteran, janë në pyetje vetëm 200 metra dhe duhet të mendoj komuna që të kyç në rrjet të kanalizimit edhe këtë familje sepse është në gjendje të rendë ekonomike. Kemi nevojë edhe për një rrugë në lagjen Kiqina që lidhet me lagjen Vrellaku dhe disa lagje të tjera që kanë nevojë për asfaltim të rrugëve, disa që janë në gjendje jo të mirë bile të shtrohen me zhavorr këtë vit, ndërsa të planifikohen për vitin e ardhshëm për asfaltim. Rruga të Elshanit ka nevojë për rrugë se është në gjendje shumë të rendë, rruga “Alush Gjylani” ka mbetur në gjendje jo të mirë dhe ka nevojë. Po ashtu kërkojë nga mbikëqyrësit e punimeve që të bëjnë kontrolla më të mëdha të punimeve, sepse kemi projekte që janë realizuar e nuk janë kryer siç duhet, kemi rrjetin e ujësjellësit që ka pasur defekte në realizim të projektit e po ashtu edhe trotuari.

**Drejtori për Infrastrukturë Lokale, Endrit Gllareva** – disa nga kërkesat e juaja kryhen gjatë këtij viti, si rregullimi i kanalizimit në disa lagje, ndërsa për projektet tjera që ju i paraqitet do të kryhen vitin e ardhshëm. Sa i përket mbikëqyrjes së projekteve, kemi kërkuar nga organet mbikëqyrëse që t'i përcjellin punimet në mënyrë që të realizohen ashtu siç janë të planifikuara e të nënshkruara në kontratë, të kundërtën do të merren masa ndaj dy palëve nëse vërtetohen parregullsi në realizimin e projekteve.

**Misin Leku, drejtor i shkollës në fshatin Baicë** – të lagja Leku, kërkohet një intervenim i shpejtë, sepse gjendja është e keqe dhe duhet sa më shpejtë të fillojë realizimi i projektit të kanalizimit.

**Arben Haziri, administrator i fshatit Krajkovë** – fshati jonë ka nevojë për rregullimin e trotuarit dhe ndriçimit, sidomos në vendet ku është frekuentimi më i madh i banorëve të fshatit. Kemi nevojë edhe për rrjetin e kanalizimit në dy lagje. Problemi më i madh është me qentë endacak, prandaj kërkohet nga Komuna që të planifikoj mjete për trajtimin e tyre, sepse kemi shumë probleme dhe po rrezikohen banorët, sidomos fëmijët.

**Drejtoresha e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, Lumnije Krapi** – sa i përket trajtimit të qenve endacak, një kohë ka qenë nga niveli qendror trajtimi i tyre, tani kompetencat kanë kaluar sërisht në nivelin lokal dhe nga mjetet mallra dhe shërbime duhet të trajtohet gjendja e tyre.

**Ramadan Ramaj, nënkyrytar i fshatit Tërdec** – kërkesa e fshatit tonë është për rregullimin e kanalizimit, në lagjen Halilaj, Tahiraj dhe Xhekaj, po ashtu kemi disa lagje pa asfalt dhe kërkojë që të planifikohen për vitin e ardhshëm. Po ashtu kemi nevojë për trotuar të rruga afér shkollës dhe për ndriçim në disa vende, sidomos të rruga ku është edhe shkolla e fshatit.

**Xhevet Demaku, administrator i fshatit Abri** – kërkojë të ndahen projektet dhe të mos mbisin si total i bashkësisë lokale. Fshati jonë ka nevojë për disa rrugë të lagjeve, e po ashtu edhe me rrjetin e kanalizimit i kemi punët keq dhe kemi nevojë përfundimin e tyre.

**Drejtori për Infrastrukturë Lokale, Endrit Gllareva** – një pjesë e projekteve që u diskutuan në këtë dëgjim, janë të planifikuara të kryhen gjatë këtij viti në bashkësinë lokale të Baicës me fshatrat përreth, ndërsa kërkesat e juaja për projektet tjera, do të planifikohen për vitin e ardhshëm sipas mundësive buxhetore që kemi dhe ndarjen e tyre sipas vendbanimeve.

**Bashkësia Lokale e Arllatit** (Arllat, Llapushnik, Negroc, Vuçak dhe Gjergjicë) më datë 20.08.2020 ora 10:30 në SHFMU “Abedin Bujupi” Arllat.

**Kërkesat e qytetarëve;**

**Istref Bytyqi, përfaqësues lagje nga fshati Arllat** – në si fshat kemi nevojë për asfaltimin e disa rrugëve që ende nuk janë kryer e po ashtu kemi nevojë edhe për ndriçim, prandaj kërkesa ime është që në buxhetin e vitit të ardhshëm të hyjë në buxhet asfaltimi i rrugicave që ende nuk janë kryer në fshatin Arllat si dhe të behët ndriçimi i rrugëve ku frekuentimi është më i madh.

**Nexhmedin Gashi, përfaqësues i lagjes Tahiraj në fshatin Llapushnik** – kemi nevojë për ndriçimin e rrugës në lagjen tonë, e po ashtu të lidhet rruga e lagjes më autostradë e të ketë ndriçim. Fshati jonë ka edhe mungesë të ujit për pije, prandaj për vitin e ardhshëm është mirë të planifikohet projekt për rregullimin e ujësjellësit.

**Halit Shala, administrator i fshatit Vuçak** – fshati jonë ka nevojë për rregullimin e trotuarit afër shkollës, ndërsa rruga që ka nisur që 4 vite ende nuk ka përfunduar, prandaj kërkojë që kjo rrugë të kryhet e të mos mbetet në gjysmë, janë përafërsisht 150 metra. Po ashtu kemi disa telashe me një gropë septike dhe është mirë që të rregullohet ky problem.

**Tefik Krasniqi nga fshati Llapushnik (Vukovc)** – në lagjen tonë që tri vite janë shtri gypat e ujit e ende nuk janë në funksion, kemi mungesë të madhe për ujë të pijshëm dhe për vitin e ardhshëm është mirë të gjetet zgjidhja për ujë se edhe banorët janë duke e lëshuar fshatin. Po ashtu rruga në hyrje të fshatit nuk është kryer siç duhet dhe ka nevojë për riparime. Ka disa vite që në fshatin tonë, përkatësisht në lagjen tonë nuk është bërë asnjë investim dhe ne këtë takim kisha kërku që të planifikohen projektet të cilat dalin nga ky dëgjim për vitin e ardhshëm.

**Avdyl Gashi, nga fshati Llapushnik** – është mirë që për vitin e ardhshëm të planifikohen mjete për mirëmbajtjen e rrugëve, pasi që shumica e tyre tani veç janë kryer. Po ashtu është mirë që të mendohet për rinin, dhe të ju krijohen objekte ku mund t'i kryejnë aktivitetet e tyre. Të krijohet qendra rimore në Drenas dhe të jetë funksionale, po ashtu sipas mundësive buxhetore të ndërtohet një qendër rimore edhe në fshatin Llapushnik afër shkollës, ka hapësirë të mjaftueshme dhe ka djem e vajza të reja që kanë kreativitetë për projekte sepse me realizimin e këtyre projekteve u jepet hapësirë të rinjve që të merren me aktivitete të ndryshme kulturore e sportive dhe i ikin dukurive negative dhe largimin nga Kosova.

**Hakif Thaqi, nga fshati Llapushnik** – në lagjen tonë nuk ka asfalt, kemi probleme edhe më ujërat e zeza, që kanalizimet derdhen në rrugë, është mirë që këto probleme të rregullohen vitin e ardhshëm dhe të merren parasysh kërkesat tona që dalin nga këto takime.

**Blerim Gashi, nga fshati Arllat** – fshati jonë ka nevojë për 4 rrugë të lagjeve, jemi me ujë shumë në gjendje të keqe, fshati ndonëse janë shti gypat e nuk janë në funksion, po ashtu edhe kanalizimi ka filluar dhe ka mbetur në gjysmë.

**Hyseni Gashi, nga fshati Llapushnik** – në fshatin tonë kemi nevojë edhe për asfaltimin e disa rrugëve që veç u përmenden, e po ashtu është e nevojshme të behët rrithoja e varrezave në fshatin tonë.

**Shumzim Bujupi, administrator i fshatit Arllat** – kisha njoftu të pranishmit se në fshatin tonë këtë vit do të përfundoj kanalizimi pjesën me të madhe të fshatit, kemi nevojë edhe për 250 metra kanalizim, po ashtu në fshat janë të nevojshme edhe asfaltimi i disa rrugicave, përkatësisht kanë mbetur edhe 4 rrugë. Kemi probleme me ujë të pijshëm në fshatin tonë, gypat janë shtri, po ashtu edhe orët e ujit janë vendosur në ekonomitë familjare dhe shumica janë në rrjet, por burimi i ujit nuk është i mjaftueshëm. Po ashtu edhe shenjat e komunikacionit duhet të vendosen në afërsi të shkolla e fshatit sepse po rrezikohen nxënësit.

**Të gjitha kërkesat e lartpërmendura të adresuara nga administratorët në këtë bashkësi lokale janë regjistruar dhe marrë shënime sipas natyrës së tyre. Po ashtu, i është dhënë përgjigje aty për aty secilit nga parashtruesit e kërkesave.**

**Bashkësia Lokale e Komoranit** ( Kizhnarekë, Nekoc, Fushticë e Ulët dhe e Epërme, Korroticë e Ulët dhe e Epërme, Zabel i Ulët dhe i Epërm, Sankoc, Komoran I, II, III dhe IV) u mbajt me datën 20.08.2020 duke filluar nga ora 13:10 në SHFMU “Xheladin Gashi-Plaku”

Mbledhjen e hapi, Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun, Bekim Dobra, duke filluar në ora 13:10, ku të pranishëm ishin: Drejtori për Buxhet dhe Financa, Shyqiri Bublaku, Drejtoresha e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, Lumnije Krapi, Drejtoresha për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Flutura Avdiu, administratorë të vendbanimeve nga bashkësia e Komoranit dhe përfaqësues të lagjeve.

#### **Kërkesat e qytetarëve;**

**Florim Shala, administrator i fshatit Zabel i Ulët** – ujësjellësi për fshatin tonë është mirë të rregullohet sepse që sa vite ka ende probleme, të shkolla e fshatit të rregullohet një mbikalim ose nënkalim sepse ju e dini sa aksidentet kanë ndodhur me fatalitet në atë vend dhe kemi pasur me humbje jete, po ashtu edhe ndriçimi në fshatin tonë, sidomos afër shkollës është shumë i nevojshëm sepse ka frekuentim shumë të madh.

**Naim Krasniai nga Komorani I** – në qendër të Komoranit është shumë e nevojshme të ndërtohet Stacioni i Policisë dhe Stacioni i Zjarrfikësve.

**Sali Berisha, nga Komorani III** – asfaltimi i rrugëve në lagjen Nishori, Vilaku dhe Obrija, përkatësisht rruga “Ymer Elshani” të asfaltohet rruga në këtë lagje. Kanalizimi në fshatin tonë një pjesë është kryer e një pjesë e kanalizimit është e bllokuar dhe duhet të hyjë në rrjet sa më shpejt se është shumë në gjendje të keqe. Kemi probleme me ujë të pijshëm, nuk kemi ujë mjaftueshëm, po ashtu edhe me kanalizim disa lagje kanë mbetur pa u përfshirë në rrjet, prandaj është mirë që për vitin e ardhshëm të merren parasysh këto kërkesa.

**Muhamed Ramadani, nënkyrjetar i fshatit Korroticë e Ulët** – kërkesë primare e fshatit tonë është uji i pijshëm që nuk kemi, jeni në dijeni që gypat janë përcjell e nuk janë funksional, kërkesa është edhe për ndriçim të rrugëve, sidomos ajo afër shkollës që është edhe rrezik i madh për nxënësit e shkollës. Kërkesë e tretë është pastrimi i deponisë në fshatin tonë, që është bërë shumë e rrezikshme dhe kërkohet largimi i saj. Si kryesues i KLSP-së, kërkojë që zyra që e kemi në Komoran të pajiset me inventarin e nevojshëm, në mënyrë që të krijohen kushtet për kryerjen e

punëve që kemi, po ashtu përkrahi idenë që të behët Stacioni Policor në Komoran dhe shërbimi i zjarrfikësve.

**Zenel Hyseni, administrator i Komoranit I** – veç u përmend ne këtë dëgjim që Komorani ka nevojë që të këtë Stacionin Policor me objekt dhe të pavarësuar e po ashtu edhe objektin e zjarrfikësve, prandaj është mirë të mendohet kjo çështje që vitin e ardhshëm të jenë këto dy objekte të finalizuara.

**Naim Krasniqi, banorë nga Komorani I** – lokacioni i tregut në Komoran nuk është definuar dhe kërkojë të definohet si vend dhe të jetë më infrastrukturën përcjellëse, asfaltim e trotuar.

**Skender Bogiqi, administrator i Komoranit IV** – kërkesa jonë është për me vazhdu rruga ku ka mbetur në gjysmë, është shumë e nevojshme të asfaltohet ajo pjesë e rrugës, janë afér 300 metra. Po ashtu është mirë që të behët pastrimi i gropës septike. Kemi mungesë të ujit, janë vendosur orët e ujit në ekonomitë familjare, por ujë nuk kemi, prandaj është mirë që kjo çështje të zgjidhet vitin e ardhshëm.

**Kadri Ajazi, administrator i fshatit Sankoc** – kërkesa e parë e fshatit tonë është për trotuar, sepse është shumë e frekuentuar nga nxënësit. Kemi disa lagje që nuk është kryer ende asfaltimi i rrugicave, kemi mungesë të ujit, janë vendosur gypat, por ata nuk janë në funksion. Për rrjetin e kanalizimit kemi nevojë në disa lagje për disa metra që të përfshihen të gjitha lagjet e fshatit. Për vitin e ardhshëm të kryhet kanalizimi dhe të rregullohen dy gropat septike.

**Gazmend Hajdini, administrator i fshatit Zabel i Epërm** – disa lagje të përfshihen për asfaltim të rrugës, lagja Ymeri dhe lagja Hajdini nuk janë kryer ende. Rruga nga lagja e Re e Komoranit është mirë të shtrohet me trotuar që e lidh fshatin tonë sepse është shumë e frekuentuar dhe të ndërtohet një fushë sportive në atë pjesë.

**Fehmi Nishori, nga Komorani III** – kërkojë nga Komuna në këto dëgjime buxhetore që për vitin e ardhshëm të rregullohet trotuari sepse është shumë i nevojshëm.

**Të gjitha kërkesat e lartpërmendura të adresuara nga administratorët në këtë bashkësi lokale janë regjistruar dhe marrë shënimë sipas natyrës së tyre. Po ashtu, i është dhënë përgjigje aty për aty secilit nga parashtruesit e kërkesave.**

**Bashkësia Lokale në Drenas** ( Drenas I, II dhe III, Poklek i Ri dhe i Vjetër, Vasilevë, Globar, lagja e Feronikelit dhe Shtrubullovë) u mbajt me datën 20.08.2020 duke filluar nga ora 14:45 në SHFMU “Rasim Kiqina”

Mbledhjen e hapi, Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun, Bekim Dobra, duke filluar në ora 14:45, ku të pranishëm ishin: Drejtori për Buxhet dhe Financa, Shyqiri Bublaku, Drejtoresha e Shërbimeve Publike dhe Emergencë, Lumnije Krapi, Drejtoresha për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Flutura Avdiu, administratorë të vendbanimeve nga bashkësia e Komoranit dhe përfaqësues të lagjeve.

**Drejtori për Buxhet e Financa, Shyqiri Bublaku** – ka informuar të pranishmit lidhur me draftin e buxhetit të ndarë nga Komuna e Drenasit për vitin 2021 dhe vitet 2022-2023.

#### **Kërkesat e qytetarëve;**

Shpend Shala, nga Drenasi I – kërkøjë nga komuna që për vitin e ardhshëm të planifikoj në rregullimin e panelave solare që janë në shesh sepse ka vite që ata nuk janë në funksion. Për vitin e ardhshëm eshtë mirë të rregullohet tregu në Drenas sepse ka mbetur shumë në gjendje të keqe, që sa vite ende nuk eshtë bërë asnjë investim në atë vend. Qyteti i Drenasit eshtë duke u rrezikuar edhe nga qentë endacak, a ka ndonjë projekt për trajtimin e tyre dhe për largimin e tyre nga qytetit. Për vitin e ardhshëm eshtë mirë që të planifikohet një shteg i çiklizmit në Drenas, sepse në shesh po i rrezikojnë fëmijët ata që po dalin me bicikleta. Po ashtu eshtë mirë të mendohet një rregullim më i mirë i këndit të lodrave, sepse po dëmtohet, me vendos pajisje më të forta të cilat nuk dëmtohen.

**Drejtoresha e Shërbimeve Publike dhe Emergencë, Lumnije Krapi** – sa i përket trajtimit të qenve endacak, deri më tani ka qenë kompetencë e nivelit qendoror trajtimi i tyre, ndërsa tani eshtë në kompetencë të komunave dhe me kodin mallra e shërbime do të behët një zgjidhje e kësaj çështje e cila eshtë problematike jo vetëm në qytet por edhe në fshatra.

Afrim Lushaku, administrator i lagjes së Feronikelit – lagja e Feronikelit me rrugë eshtë në gjendje jo të mirë, prandaj për vitin e ardhshëm eshtë mirë të përfshihen rregullimi i rrugëve në lagjen tonë sepse nuk ka pasur asnjë investim në atë pjesë asnjëherë dhe gjenja e tyre eshtë shumë e keqe. Po ashtu edhe rrjeti i kanalizimit duhet të rregullohet, prandaj kërkøjë që në projekt buxhetin për vitin 2021 të hyjnë këto dy kërkesa me prioritet.

Afrim Gjeli, administrator i Poklekut të Ri – Pokleku ka nevojë për ndriçim publik në disa rrugë, sepse eshtë paralagje e qytetit. Rrethoja e varrezave eshtë shumë e nevojshme, po ashtu janë edhe disa metra që kanë nevojë për asfaltim të rrugëve. Në Poklek ka nevojë edhe për rregullimin e trotuarit, po ashtu edhe për një parking për vetura të Palestra e Qytetit “Hysni Jetullahi” dhe të Stadiumi “Rexhep Rexhepi”, sepse kur po zhvillohen ndeshjet sportive komplet banorët e Poklekut po bllokohen nga veturat që po parkohen. Rruga “Nystret Halilaj” eshtë e pa asfaltuar, janë afersisht 1700 metra që kanë nevojë të asfaltohen. Kemi nevojë edhe për rrjetin e kanalizimit që janë 400 metra dhe më rregullimin e kësaj pjese përfshihet i gjithë fshati në rrjetin e kanalizimit. Kemi nevojë edhe për ndriçim publik, shtyllat janë mungon ndriçimi. Të gjitha kërkesat për

projektet që kanë nevojë Pokleku i Ri i kam paraqitur edhe me shkrim në drejtoritë përkatëse përmes protokollit.

Afrim Berisha, administrator nga fshati Vasilevë – kërkesa jonë është për ujësjellës, nuk kemi ujë dhe ka shumë probleme ne shumicën e fshatit për ujë të pijshëm. Po ashtu kërkesa jonë është edhe për asfaltim të rrugës deri të përmendorja e fshatit.

Zekë Kluna, administrator nga Pokleku i Vjetër – kërkojë që t'i behët një zgjidhje ujit të thart, ka mbetur në gjendje tejet të keqe, është mirë që Komuna për vitin e ardhshëm të zgjidh atë problem, ka qenë dikur vendi më i frekuentuar në fshatin tonë, tani ka mbetur në gjendje të mjerueshme si pasojë e mos kujdesit ndaj asaj bukurie natyrore. Kjo ka ardhur si pasojë edhe e rrjetit të kanalizimit që e ka dëmtuar burimin e ujit të thart, prandaj fshati ka nevojë edhe për rregullimin e rrjetit të kanalizimit. Kemi nevojë edhe për asfaltim të rrugës, kanë mbetur edhe disa metra që janë shumë të nevojshme, po ashtu edhe për ndriçim publik në disa rrugë kemi nevojë, prandaj kërkojë që për vitin e ardhshëm të merren parasysh kërkesa tona.

Nebih Bajraktari, administrator nga Drenasi III (Çikatovë e Re) – Drenasit III ka nevojë për trotuar në disa pjesë, po ashtu kemi nevojë edhe për 3 rrugë të asfaltohen, janë pak metra, ndërsa rrjeti i kanalizimit duhet të rregullohet, janë bërë bllokime të gropave septike sidomos kur kemi të reshura ujërat e zeza dalin mbi tokë. Në disa rrugë është shumë e nevojshme të behët ndriçimi, të objektet e banimit social gjendja është shumë e rendë, nuk ka park dhe gjelbërim, madje edhe gjendjen me mbeturina e kanë shumë keq. Më së e nevojshme është edhe trotuari dhe rregullimi i kanalizimit e po ashtu edhe shtyllat elektrike të jenë nën tokë, jo mbi tokë, sepse Drenasi III është zonë urbane, jo rurale.

Lidhur me këto kërkesa të adresuara nga administratorët e fshatrave u mbajtën shënimë dhe u regjistruan në mënyrë që të përfshihen në KAB.

#### Raportin e hartozi:

**Bekim Dobra, Shef i Zyrës së Informimit**



REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
Prantuar	28.08	2020	
Nj. Org.	Numër	Shtoja	Vlera
01-	060-	35526	



Republika e Kosovës  
Komuna e Drenasit  
Zyra e Kryetarit të Komunës  
Drenas, më 28.08.2020



### PROCESVERBAL I dëgjimit buxhetor publik për vitet 2021-2023

**Bashkësia Lokale e Dobroshecit** (Gradicë, Likoshan, Godanc, Dobroshec, Gllanasellë dhe Çikatovë e Vjetër) më datë. 19.08.2020, ora 10:30 në SHFMU "Rilindja" Dobroshec.



Mbledhjen e hapi Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun, Bekim Dobra, duke filluar në ora 10:30, ku të pranishëm ishin: Nënkyetari i Komunës, Nazmi Hasi, Drejtori për Infrastrukturë Lokale, Endrit Gllareva, Drejtoresha për Planifikim, Flutura Avdiu, Drejtoresha për Shërbime Publike, Lumnije Krapi, Drejtori për Buxhet dhe Financa, Shyqiri Bublaku, Drejtoresha për Zhvillim Ekonomik, Egzona Jetullahi, Drejtori për Arsim, Muhamet Gjoka, U.D e Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Arberiye Gllareva, administratorë të vendbanimeve nga bashkësia e Dobroshecit dhe përfaqësues të lagjeve.

Fillimisht, Bekim Dobra i përshëndeti të gjithë administratorët e fshatit dhe qytetarët e pranishëm në takim, dhe shpalosi detajet e këtij takimi. Dobra ka njoftuar të pranishmit për rendin e ditës dhe ka treguar rregullat e takimit. Për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia globale COVID-19,

takimet janë mbajtur në ambiente të hapura, me përdorimin e maskave dhe mbajtjen e distancës. Të pranishmit janë pajisur me draft-listën e investimeve kapitale për vendbanimin e tyre dhe janë njoftuar për buxhetin e ndarë për vitet në vazhdim.

Rend dite:

1. Informatë e përgjithshme lidhur me buxhetin komunal 2021-2023.
2. Lista e investimeve kapitale në Bashkësinë e Dobroshecit.
3. Kërkesat e banorëve.

**Drejtori i Financave, Shyqiri Bublaku:** Përshëndeti të gjithë banorët e fshatrave të kësaj bashkësie dhe i informoi për punën që Komuna e Drenasit po e bënë për qytetarët e saj dhe projektet që ka realizuar dhe që do realizohen në vitet në vijim. Bublaku ka falënderuar të pranishmit që kanë gjetur kohën të jenë pjesë e këtyre dëgjimeve buxhetore dhe ka thënë se takimet e zhvendosura në lokalitete, kanë për qëllim që të hartojnë një buxhet sa me të mirë me projekte konkrete që dalin nga qytetarët të cilët marrin pjesë në këto takime. Ai ka treguar para të pranishmeve edhe për mjetet buxhetore që ka planifikuar komuna.

**Kërkesat e qytetarëve;**

**Albert Nika – Administrator i fshatit Gllanasellë** – ne i kemi paraqitur të gjitha kërkesat në formë fizike edhe përmes protokollit dhe të njëjtat i kemi paraqitur edhe në takimin e mbajtur në muajin qershor të këtij viti, megjithatë pasi që po mbahet edhe ky dëgjim, po i përmendi ato që janë me të rëndësishmet. Në fshatin tonë kanë mbetur edhe 400 metra kanalizim, ndërsa kemi nevojë për ndriçim publik të disa rrugëve, sidomos ajo që është më e frekuentuara nga shkolla dhe ambulanta e fshatit. Edhe rrjeti i ujësjellësit në fshat nuk është funksional dhe është mirë që Komuna të mendoj për këtë projekt dhe të planifikoj mjete për të rregulluar sepse me ujë të pijshëm e kemi gjendjen jo mirë. Pasi që i kam paraqitur kërkesat edhe me shkrim dhe në takimin e fundit, për të mos ju marr kohë të tjerëve, nuk isha zgjatur më shumë në këtë debat.

**Mehmet Kurrumeli – përfaqësues i lagjes Kurrumeli në fshatin Gllanasellë** – në lagjen tonë kemi problem me ujë të pijshëm, e kemi gypin, por nuk është aktivizuar asnjëherë. Fshati është i lidhur me gypin e shkollës, prandaj kërkojë që të rregullohet rrjeti i ujësjellësit që është problem që 15 vite kur është ndërtuar me vetëfinancim të banorëve të fshatit. Gypi është dëmtuar dhe besoj që tani është edhe jo funksional. Kemi nevojë edhe për trotuar deri të shkolla, sepse ajo pjesë është shumë e frekuentuar nga nxënësit dhe po rrezikohen.

**Drejtori i Financave, Shyqeri Bublaku** – lënda e ujësjellësit është në hetuesi, për shkak të problemeve që ka pasur nga e kaluara që projekti nuk është kryer siç duhet dhe dëri në përfundimin e procedurave gjyqësore, nuk po mundemi të ekzekutojmë projektin, ndonëse mjetet janë ndarë dhe janë në dispozicion për t'u finalizuar projekti që i lidh 22 vendbanime për t'i furnizuar me rrjetin e ujësjellësit.

**Drejtoresha e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, Lumnije Krapi** – jemi në dijeni lidhur me këtë gyp të ujësjellësit në fshatin Gllanasellë, kemi biseduar me drejtorin e ujësjellësit në Drenas dhe na kanë njoftuar se do të merren me këtë çështje për të rregulluar.

**Hysen Avdyli – Administrator i fshatit Likoshan** – edhe ne i kemi bërë kërkesat tona lidhur me projektet përmes protokollit, por edhe sot po i paraqesim kërkesat tona lidhur me projektet që janë të nevojshme. Kemi 2 rrugica nga 250 metra për asfaltim e po ashtu kemi edhe për 200 metra kanalizim. Për ujë po e dini edhe ju që gjendja nuk është aspak e mirë dhe kemi nevojë, është vendosur gypi i ujësjellësit, por ai nuk është funksional. Kemi nevojë edhe për ndriçim të një rruge ku është më e frekuentuar dhe që ju kemi bërë kërkesë edhe përmes shkrimit.

**Arsim Avdyli – nga fshati Dobroshec** – mungesa e kanalizimeve në lagjen Ademi, por edhe në lagjen Avdypi e Prenku nuk është përfunduar dhe kemi probleme me rrjetet e kanalizimeve. Shkolla e fshatit është e kyçur, por ka mbetur vetëm ambulanta e fshatit të kyçet në rrjetin e kanalizimit pasi që janë afér njëra tjetrës dhe me pak metra rregullohet edhe problemi i kanalizimit të këtij objekti. Shkolla e fshatit është në gjendje jo të mirë, është shkolla e parë në Drenas dhe ky objekt ka nevojë për hapësira me të madhe, për kabinete e salla të tjera, kësaj shkolle i mungon edhe fusha sportive.

**Esat Fejza – përfaqësues i lagjes Fejza në fshatin Dobroshec** – unaza e fshatit është mirë të jetë prioritet për asfaltim, po ashtu kemi nevojë edhe për ndriçim të rrugëve në lagjen tonë.

**Drejtori i Infrastrukturës Lokale, Endrit Gllareva** – ne e kemi filluar ju e dini asfaltimin e unazës së asaj pjesë që po e përmendni, por kemi pasur disa probleme pronësore.

**Drejtoresha e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, Lumnije Krapi** – lidhur me ndriçimet në vendbanime, ne e kemi kodin e bashkëfinancimit të projekteve dhe mundeni edhe vetë lagjet me u organizu për rregullimin e tyre, ndërsa faturat e shpenzimeve pastaj i bartën komunës. Kemi disa lagje në fshatra që janë rregulluar.

**Qerim Bërbatovci – Administrator i fshatit Godanc** – kemi nevojë për asfaltimin e rrugës Godanc-Gllanasellë, vitin e kaluar ka qenë për t'u kryer gjatë këtij viti, kisha pas dëshirë me e ditë a është në planifikim për këtë vit, apo duhet planifikuar për vitin e ardhshëm. Po ashtu në fshatin tonë kemi mbetur edhe disa lagje pa kanalizim, kemi nevojë edhe për projektin me ujë të pijës, nuk është funksional rrjeti i ujësjellësit.

**Drejtori i Infrastrukturës Lokale, Endrit Gllareva** – rruga Gllanasellë-Godanc do të përfundoj gjatë këtij viti, ndërsa rrjeti i kanalizimit është i planifikuar për vitin e ardhshëm.

**Olivera Isufi, mësimdhënëse në shkollën e fshatit Dobroshec** – kisha pas dëshirë me e ditë lidhur me shujtat e mësimdhënësve, a është planifikuar diçka lidhur me pagesat për vitin e ardhshëm.

**Drejtori për Buxhet e Financa, Shyqeri Bublaku** – nuk është e mundur të hyjë në buxhet një kod i tillë ende kjo çeshtje si kategori. Nënshkrimi i kontratës kolektive për shujta është bërë pa një planifikim dhe komunave po ju del problem në pagesat përmes formës përbartimore.

**Drejtori i Arsimit, Muhamet Gjoka** – shujta është e drejtë që ju takon, por kur është nënshkruar kontrata, nuk është menduar mirë masa buxhetore, prandaj nuk mund të rregullohet ende, sepse ka një kosto shumë të madhe.

**Bashkësia Lokale e Tërstenikut** (Tërstenik I dhe II, Vërboc, Polluzhë dhe Shtuticë) më datë. 19.08.2020, ora 13:10 në SHFMU “Zelen Hajdini” Tërstenik.



Mbledhjen e hapi Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun, Bekim Dobra, duke filluar në ora 13:10, ku të pranishëm ishin: Nënkyretari i Komunës, Nazmi Hasi, Drejtori për Infrastrukturë Lokale, Endrit Gllareva, Drejtori për Buxhet dhe Financa, Shyqiri Bublaku, Drejtoresha për Zhvillim Ekonomik, Egzona Jetullahi, Drejtoresha për Planifikim, Flutura Avdiu dhe U.D Drejtoresha për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Arberije Gllareva, administratorë të vendbanimeve nga bashkësia e Tërstenikut dhe përfaqësues të lagjeve

Fillimisht, Bekim Dobra i përshtëndeti të gjithë administratorët e fshatit dhe qytetarët e pranishëm në takim, dhe shpalosi detajet e këtij takimi. Dobra ka njoftuar të pranishmit përendin e ditës dhe ka treguar rregullat e takimit. Për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia globale COVID-19, takimi është mbajtur në ambient të hapura të shkollës “Zelen Hajdini” në Tërstenik, me përdorimin e maskave dhe mbajtjen e distancës. Të pranishmit janë pajisur me draft-listën e investimeve kapitale përvendbanimin e tyre dhe janë njoftuar përbuxhetin e ndarë përvitet në vazhdim.

Rend dite:

1. Informatë e përgjithshme lidhur me buxhetin komunal 2021-2023.
2. Lista e investimeve kapitale në Bashkësinë e Tërstenikut.
3. Kërkesat e banorëve.

**Bekim Dobra** – ka përshëndetur dhe falënderuar të pranishmit për pjesëmarrje, dhe i ka njoftuar për mjetet e qarkores buxhetore për projektet e investimeve kapitale. Ai ka shtuar se për të ju lehtesar qytetarëve pjesëmarrës ne këto takime, Komuna ka përgatitur listat e investimeve kapitale sipas fshatrave dhe vendbanimeve për të ju lehtesar debatin pjesëmarrësve.

**Drejtori për Buxhet e Financa, Shyqiri Bublaku** – ka informuar të pranishmit lidhur me draftin e buxhetit të ndarë nga Komuna e Drenasit për vitin 2021 dhe vitet 2022-2023.

**Kërkesat e qytetarëve;**

**Nazmi Mulaj, përfaqësues i lagjes Mulaj në Tërstenik II** – kemi problem me kanalizim në lagjen tonë, po ashtu në lagjen te Selimt janë rreth 600 metra për asfaltim që janë shumë të rëndësishme. Kanalizimi është mbi tokë dhe po shkakton probleme të mëdha, nuk kemi ende diçka konkrete lidhur me këtë kanalizim, ky kanalizim po i dëmton edhe puset private të banorëve.

**Drejtori për Infrastrukturë Lokale, Endrit Gllareva** – rrjeti i kanalizimit në lagjen Mulaj përfundon gjatë këtij viti, një pjesë edhe e rrugës po ashtu, por pjesa tjetër e lagjeve është planifikuar për vitin e ardhshëm.

**Nazmi Mulaj** – po ashtu edhe lagja Munisht dhe lagja Franca kanë nevojë për asfaltim të rrugës se e kanë në gjendje shumë të keqe.

**Ilmi Kastrati, nënkyrytar i fshatit Polluzhë** – në lagjen Kastrati kemi problem për mbikalimin, na kanë thënë se do të kryhet gjatë këtij viti, por po presim që të behët një zgjidhje. Kemi nevojë për rregullimin e trotuareve ne një pjesë të rrugës ku ka frekuencim, po ashtu kemi probleme me ujë për piye nuk ka fare në fshat, pastaj po ashtu edhe me rrjetin e kanalizimeve, ku edhe oborri i shkollës është mbushur me ujë nga kanalizimet.

**Drejtori për Infrastrukturë Lokale, Endrit Gllareva** – do të behët mbikalimi sepse kemi bërë kërkesë në Ministri dhe na kanë njoftuar se do të kryhet. Ndërsa në rrjetin e kanalizimit është duke u punuar me kolektorë që përfshihet komplekt fshati Polluzhë.

**Drejtoresha e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, Lumnije Krapi** – sa i përket kanalizimeve, ne i bëjmë ndërhyrjet në ato vende ku ka bllokime për deblllokimin e tyre, edhe në fshatin Polluzhë kemi bërë disa herë intervenime, por besoj që këtë vit me rregullimin e kolektorëve, do të eliminohet ky problem.

**Rexhep Istogu, administrator i fshatit Polluzhë** – të lagja Istogu, gropat septike duhet të mbulohen dhe të mos mbisin në atë gjendje sepse po irrezikohen banorët. Shkolla është në

gjendje jo të mirë, po ashtu edhe ujësjellësi është në gjendje të keqe dhe nuk kemi fare dhe kemi si prioritet të rregullohet.

**Nënkyetari i Komunës, Nazmi Hasi** – sa i përket rrjetit të ujësjellësit, procedurat e këtij projekti janë në hetime për shkak të defekteve të viteve paraprake dhe pa përfunduar ato, nuk mund të fillojmë me realizimin e projektit, me përfundimin e tyre, ne do të fillojmë në realizimin e projektit i cili do të përfshinë 22 vendbanime.

**Valdet Dvorani, përfaqësues i lagjes Dvorani në fshatin Tërstenik I** – rreth rrjetit të kanalizimit e di që në fshat ka përfunduar rreth 90 për qind të tij, por në lagjen Dvorani nuk janë lidhur lagja dhe ka mbetur pa u përfshirë në këtë rrjet të kanalizimit. Kemi edhe disa rrugë në fshat që nuk janë kryer me asfaltim dhe janë shumë të nevojshme sepse kanë kyçje direkt në autostradë. Të rruga kryesore nuk është planifikuar të behët një nënkalim dhe jemi tejet të rrezikuar, sidomos fëmijët që kanë vajte-ardhjen në shkollë.

**Drejtori i Infrastrukturës Lokale, Endrit Gllareva** – sa i përket trotuarit e kam bërë kërkesën në Ministri për pëlqim, momentin që kthehet pëlqimi do të shtrohet trotuari.

**Avni Gjoka, përfaqësues i lagjes Gjoka, Tërstenik II** – ju përgëzoj për punën e bërë deri më tanë, por kemi probleme me rrjetin e kanalizimit në lagjen Gjoka, janë disa metra të pa kryera, e po ashtu rrjeti i kanalizimit është në gjendje të keqe edhe në lagjet tjera, prandaj kërkoj që për vitin e ardhshëm të jetë prioritet përfundimi i rrjetit të kanalizimit në fshatin tonë.

**Bashkësia Lokale e Baicës** (Abri, Tërdec, Baicë, Krajkovë dhe Damanek) më datë. 19.08.2020 ora 14:54 në SHFMU “Migjeni” Baicë.



Mbledhjen e hapi, Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun, Bekim Dobra, duke filluar në ora 14:45, ku të pranishëm ishin: Nënkyryetari i Komunës, Nazmi Hasi, Drejtori për Infrastrukturë Lokale, Endit Gllareva, Drejtori për Buxhet dhe Financa, Shyqiri Bublaku, Drejtoresha e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, Lumnije Krapi, Drejtoresha për Zhvillim Ekonomik, Egzona Jetullahi, U.D Drejtoresha për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Arberiye Gllareva, administratorë të vendbanimeve nga bashkësia e Baicës dhe përfaqësues të lagjeve

Fillimisht, Bekim Dobra i përshëndeti të gjithë administratorët e fshatit dhe qytetarët e pranishëm në takim, dhe shpalosi detajet e këtij takimi. Dobra ka njoftuar të pranishmit për rendin e ditës dhe ka treguar rregullat e takimit. Për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia globale COVID-19, takimi është mbajtur në ambient të shkollës "Migjeni" në Baicë, me përdorimin e maskave dhe mbajtjen e distancës. Të pranishmit janë pajisur me draft-listën e investimeve kapitale për vendbanimin e tyre dhe janë njoftuar për buxhetin e ndarë për vitet në vazhdim.

Rend dite:

1. Informatë e përgjithshme lidhur me buxhetin komunal 2021-2023.
2. Lista e investimeve kapitale në Bashkësinë e Baicës.
3. Kërkesat e banorëve.

**Bekim Dobra** – ka përshëndetur dhe falënderuar të pranishmit për pjesëmarrje, dhe i ka njoftuar për mjetet e qarkores buxhetore për projektet e investimeve kapitale. Ai ka shtuar se për të ju lehtësuar qytetarëve pjesëmarrës ne këto takime, Komuna ka përgatitur listat e investimeve kapitale sipas fshatrave dhe vendbanimeve për të ju lehtësuar debatin pjesëmarrësve.

**Drejtori për Buxhet e Financa, Shyqiri Bublaku** – ka informuar të pranishmit lidhur me draftin e buxhetit të ndarë nga Komuna e Drenasit për vitin 2021 dhe vitet 2022-2023.

**Kërkesat e qytetarëve;**

**Mehmet Zariqi, përfaqësues i lagjes Zariqi në fshatin Baicë** – rruga në lagjen Zariqi nuk është e përfshirë në këto listat që na i keni sjell, një familje ka mbetur pa u përfshi në rrjetin e kanalizimit, gjatësia është mbi 200 metra.

**Samedin Kiqina, administrator i fshatit Baicë** – ne si fshat kemi probleme me kanalizimin në disa lagje. Lagja Leku, Kiqina, Binaku nuk janë ende të kyçura në rrjetin e kanalizimit. Kemi në gjendje jo të mirë një familje mbi shkollë që ka mbetur pa u përfshi në rrjetin e kanalizimit, është veteran, janë në pyetje vetëm 200 metra dhe duhet të mendoj komuna që të kyç në rrjet të kanalizimit edhe këtë familje sepse është në gjendje të rendë ekonomike. Kemi nevojë edhe për një rrugë në lagjen Kiqina që lidhet me lagjen Vrellaku dhe disa lagje të tjera që kanë nevojë për asfaltim të rrugëve, disa që janë në gjendje jo të mirë bile të shtrohen me zhavorr këtë vit, ndërsa të planifikohen për vitin e ardhshëm për asfaltim. Rruga të Elshant ka nevojë për rrugë se është në gjendje shumë të rendë, rruga "Alush Gjylani" ka mbetur në gjendje jo të mirë dhe ka nevojë. Po ashtu kërkojë nga mbikëqyrësit e punimeve që të bëjnë kontrolla më të mëdha të punimeve, sepse kemi projekte që janë realizuar e nuk janë kryer siç

duhet, kemi rrjetin e ujësjellësit që ka pasur defekte në realizim të projektit e po ashtu edhe trotuari.

**Drejtori për Infrastrukturë Lokale, Endrit Gllareva** – disa nga kërkesat e juaja kryhen gjatë këtij viti, si rregullimi i kanalizimit në disa lagje, ndërsa për projektet tjera që ju i paraqitet do të kryhen vitin e ardhshëm. Sa i përket mbikëqyrjes së projekteve, kemi kërkuar nga organet mbikëqyrëse që t'i përcjellin punimet në mënyrë që të realizohen ashtu siç janë të planifikuara e të nënshkruara në kontratë, të kundërtën do të merren masa ndaj dy palëve nëse vërtetohen parregullsi në realizimin e projekteve.

**Misin Leku, drejtor i shkollës në fshatin Baicë** – të lagja Leku, kërkohet një intervenim i shpejtë, sepse gjendja është e keqe dhe duhet sa më shpejtë të fillojë realizimi i projektit të kanalizimit.

**Arben Haziri, administrator i fshatit Krajkovë** – fshati jonë ka nevojë për rregullimin e trotuarit dhe ndriçimit, sidomos në vendet ku është frekuentimi më i madh i banorëve të fshatit. Kemi nevojë edhe përrjetin e kanalizimit në dy lagje. Problemi më i madh është me qentë endacak, prandaj kërkohet nga Komuna që të planifikoj mjete për trajtimin e tyre, sepse kemi shumë probleme dhe po rrezikohen banorët, sidomos fëmijët.

**Drejtoresha e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, Lumnije Krapi** – sa i përket trajtimit të qenve endacak, një kohë ka qenë nga niveli qendror trajtimi i tyre, tanë kompetencat kanë kaluar sërisht në nivelin lokal dhe nga mjetet mallra dhe shërbime duhet të trajtohet gjendja e tyre.

**Ramadan Ramaj, nënkyrytar i fshatit Tërdec** – kërkesa e fshatit tonë është përrregullimin e kanalizimit, në lagjen Halilaj, Tahiraj dhe Xhekaj, po ashtu kemi disa lagje pa asfalt dhe kërkojë që të planifikohen për vitin e ardhshëm. Po ashtu kemi nevojë për trotuar të rruga afër shkollës dhe për ndriçim në disa vende, sidomos të rruga ku është edhe shkolla e fshatit.

**Xhevjet Demaku, administrator i fshatit Abri** – kërkojë të ndahen projektet dhe të mos mbisin si total i bashkësisë lokale. Fshati jonë ka nevojë për disa rrugë të lagjeve, e po ashtu edhe me rrjetin e kanalizimit i kemi punët keq dhe kemi nevojë përfundimin e tyre.

**Drejtori për Infrastrukturë Lokale, Endrit Gllareva** – një pjesë e projekteve që u diskutuan në këtë dëgjim, janë të planifikuara të kryhen gjatë këtij viti në bashkësinë lokale të Baicës me fshatrat përreth, ndërsa kërkesat e juaja për projektet tjera, do të planifikohen për vitin e ardhshëm sipas mundësive buxhetore që kemi dhe ndarjen e tyre sipas vendbanimeve.

**Bashkësia Lokale e Arllatit** (Arllat, Llapushnik, Negroc, Vuçak dhe Gjergjicë) më datë 20.08.2020 ora 10:30 në SHFMU “Abedin Bujupi” Arllat.



Mbledhjen e hapi, Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun, Bekim Dobra, duke filluar në ora 10:30, ku të pranishëm ishin: Drejtori për Infrastrukturë Lokale, Endit Gllareva, Drejtori për Buxhet dhe Financa, Shyqiri Bublaku, Drejtoresha e Shërbimeve Publike dhe Emergencë, Lumnije Krapi, Drejtoresha për Zhvillim Ekonomik, Egzona Jetullahi, U.D Drejtoresha për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Arberije Gllareva, administratorë të vendbanimeve nga bashkësia e Baicës dhe përfaqësues të lagjeve

Fillimisht, Bekim Dobra i përshëndeti të gjithë administratorët e fshatit dhe qytetarët e pranishëm në takim, dhe shpalosi detajet e këtij takimi. Dobra ka njoftuar të pranishmit për rendin e ditës dhe ka treguar rregullat e takimit. Për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia globale COVID-19, takimi është mbajtur në ambient të shkollës "Abedin Bujupi" në Arllat, me përdorimin e maskave dhe mbajtjen e distancës. Të pranishmit janë pajisur me draft-listën e investimeve kapitale për vendbanimin e tyre dhe janë njoftuar për buxhetin e ndarë për vitet në vazhdim. Të pranishmëve i është paraqitur edhe rendi i ditës së këtij dëgjimi buxhetor;

Rend dite:

1. Informatë e përgjithshme lidhur me buxhetin komunal 2021-2023.
2. Lista e investimeve kapitale në Bashkësinë e Baicës.
3. Kërkesat e banorëve.

**Bekim Dobra** – ka përshëndetur dhe falënderuar të pranishmit për pjesëmarrje, dhe i ka njoftuar për mjetet e qarkores buxhetore për projektet e investimeve kapitale. Ai ka shtuar se për të ju lehtësuar qytetarëve pjesëmarrës ne këto takime, Komuna ka përgatitur listat e investimeve kapitale sipas fshatrave dhe vendbanimeve për të ju lehtësuar debatin pjesëmarrësve.

**Drejtori për Buxhet e Financa, Shyqiri Bublaku** – ka informuar të pranishmit lidhur me draftin e buxhetit të ndarë nga Komuna e Drenasit për vitin 2021 dhe vitet 2022-2023.

**Kërkesat e qytetarëve;**

**Istref Bytyqi, përfaqësues lagje nga fshati Arllat** – në si fshat kemi nevojë për asfaltimin e disa rrugëve që ende nuk janë kryer e po ashtu kemi nevojë edhe për ndriçim, prandaj kërkesa ime është që në buxhetin e vitit të ardhshëm të hyjë në buxhet asfaltimi i rrugicave që ende nuk janë kryer në fshatin Arllat si dhe të behët ndriçimi i rrugëve ku frekuentimi është më i madh.

**Nexhmedin Gashi, përfaqësues i lagjes Tahiraj në fshatin Llapushnik** – kemi nevojë për ndriçimin e rrugës në lagjen tonë, e po ashtu të lidhet rruga e lagjes më autostradë e të ketë ndriçim. Fshati jonë ka edhe mungesë të ujit për pije, prandaj për vitin e ardhshëm është mirë të planifikohet projekt për rregullimin e ujësjellësit.

**Halit Shala, administrator i fshatit Vuçak** – fshati jonë ka nevojë për rregullimin e trotuarit afér shkollës, ndërsa rruga që ka nisur që 4 vite ende nuk ka përfunduar, prandaj kërkojë që kjo rrugë të kryhet e të mos mbetet në gjysmë, janë përafërsisht 150 metra. Po ashtu kemi disa telashe me një gropë septike dhe është mirë që të rregullohet ky problem.

**Tefik Krasniqi nga fshati Llapushnik (Vukovc)** – në lagjen tonë që tri vite janë shtri gypat e ujit e ende nuk janë në funksion, kemi mungesë të madhe për ujë të pijshëm dhe për vitin e ardhshëm është mirë të gjetet zgjidhja për ujë se edhe banorët janë duke e lëshuar fshatin. Po ashtu rruga në hyrje të fshatit nuk është kryer siç duhet dhe ka nevojë për riparime. Ka disa vite që në fshatin tonë, përkatësisht në lagjen tonë nuk është bërë asnjë investim dhe ne këtë takim kisha kërku që të planifikohen projektet të cilat dalin nga ky dëgjim për vitin e ardhshëm.

**Avdyl Gashi, nga fshati Llapushnik** – është mirë që për vitin e ardhshëm të planifikohen mjete për mirëmbajtjen e rrugëve, pasi që shumica e tyre tani veç janë kryer. Po ashtu është mirë që të mendohet për rinin, dhe të ju krijohen objekte ku mund t'i kryejnë aktivitetet e tyre. Të krijohet qendra rimore në Drenas dhe të jetë funksionale, po ashtu sipas mundësive buxhetore të ndërtohet një qendër rimore edhe në fshatin Llapushnik afér shkollës, ka hapësirë të mjaftueshme dhe ka djem e vajza të reja që kanë kreativitet për projekte sepse me realizimin e këtyre projekteve u jepet hapësirë të rinxve që të merren me aktivitete të ndryshme kulturore e sportive dhe i ikin dukurive negative dhe largimin nga Kosova.

**Hakif Thaqi, nga fshati Llapushnik** – në lagjen tonë nuk ka asfalt, kemi probleme edhe më ujërat e zeza, që kanalizimet derdhen në rrugë, është mirë që këto probleme të rregullohen vitin e ardhshëm dhe të merren parasysh kërkesat tona që dalin nga këto takime.

**Blerim Gashi, nga fshati Arllat** – fshati jonë ka nevojë për 4 rrugë të lagjeve, jemi me ujë shumë në gjendje të keqe, fshati ndonëse janë shti gypat e nuk janë në funksion, po ashtu edhe kanalizimi ka filluar dhe ka mbetur në gjysmë.

**Hyseni Gashi, nga fshati Llapushnik** – në fshatin tonë kemi nevojë edhe për asfaltimin e disa rrugëve që veç u përmenden, e po ashtu është e nevojshme të behët rrithoja e varrezave në fshatin tonë.

**Shumzim Bujupi, administrator i fshatit Arllat** – kisha njoftu të pranishmit se në fshatin tonë këtë vit do të përfundoj kanalizimi pjesën me të madhe të fshatit, kemi nevojë edhe për 250 metra kanalizim, po ashtu në fshat janë të nevojshme edhe asfaltimi i disa rrugicave, përkatësisht kanë mbetur edhe 4 rrugë. Kemi probleme me ujë të pijshëm në fshatin tonë, gypat janë shtri, po ashtu edhe orët e ujit janë vendosur në ekonomitë familjare dhe shumica janë në rrjet, por burimi i ujit nuk është i mjaftueshëm. Po ashtu edhe shenjat e komunikacionit duhet të vendosen në afërsi të shkolla e fshatit sepse po rrezikohen nxënësit.

**Bashkësia Lokale e Komoranit** (Kizhnarekë, Nekoc, Fushticë e Ulët dhe e Epërme, Korroticë e Ulët dhe e Epërme, Zabel i Ulët dhe i Epërm, Sankoc, Komoran I, II, III dhe IV) u mbajt me datën 20.08.2020 duke filluar nga ora 13:10 në SHFMU “Xheladin Gashi-Plaku”



Mbledhjen e hapi, Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun, Bekim Dobra, duke filluar në ora 13:10, ku të pranishëm ishin: Drejtori për Buxhet dhe Financa, Shyqiri Blablaku, Drejtoresha e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, Lumnije Krapi, Drejtoresha për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Flutura Avdiu, administratorë të vendbanimeve nga bashkësia e Komoranit dhe përfaqësues të lagjeve.

Fillimisht, Bekim Dobra i përshëndeti të gjithë administratorët e fshatit dhe qytetarët e pranishëm në takim, dhe shpalosi detajet e këtij takimi. Dobra ka njoftuar të pranishmit për rendin e ditës dhe ka treguar rregullat e takimit. Për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia globale COVID-19, takimi është mbajtur në ambient të shkollës “Xheladin Gashi-Plaku” në Komoran, me përdorimin e maskave dhe mbajtjen e distancës. Të pranishmit janë pajisur me draft-listën e investimeve kapitale për vendbanimin e tyre dhe janë njoftuar për buxhetin e ndarë për vitet në vazhdim. Të pranishmëve i është paraqitur edhe rendi i ditës së këtij dëgjimi buxhetor;

Rend dite:

4. Informatë e përgjithshme lidhur me buxhetin komunal 2021-2023.
5. Lista e investimeve kapitale në Bashkësinë e Komoranit.
6. Kërkesat e banorëve.

**Bekim Dobra** – ka përshëndetur dhe falënderuar të pranishmit për pjesëmarje, dhe i ka njoftuar për mjetet e qarkores buxhetore për projektet e investimeve kapitale. Ai ka shtuar se për të ju lehtësuar qytetarëve pjesëmarrës ne këto takime, Komuna ka përgatitur listat e investimeve kapitale sipas fshatrave dhe vendbanimeve për të ju lehtësuar debatin pjesëmarrësve.

**Drejtori për Buxhet e Financa, Shyqiri Bublaku** – ka informuar të pranishmit lidhur me draftin e buxhetit të ndarë nga Komuna e Drenasit për vitin 2021 dhe vitet 2022-2023.

**Kërkesat e qytetarëve;**

**Florim Shala, administrator i fshatit Zabel i Ulët** – ujësjellësi për fshatin tonë është mirë të rregullohet sepse që sa vite ka ende probleme, të shkolla e fshatit të rregullohet një mbikalim ose nënkalim sepse ju e dini sa aksidentet kanë ndodhur me fatalitet në atë vend dhe kemi pasur me humbje jete, po ashtu edhe ndriçimi në fshatin tonë, sidomos afër shkollës është shumë i nevojshëm sepse ka frekuentim shumë të madh.

**Naim Krasniai nga Komorani I** – në qendër të Komoranit është shumë e nevojshme të ndërtohet Stacioni i Policisë dhe Stacioni i Zjarrfikësve.

**Sali Berisha, nga Komorani III** – asfaltimi i rrugëve në lagjen Nishori, Vilaku dhe Obrija, përkatësisht rruga “Ymer Elshani” të asfaltohet rruga në këtë lagje. Kanalizimi në fshatin tonë një pjesë është kryer e një pjese e kanalizimit është e blokuar dhe duhet të hyjë në rrjet sa më shpejt se është shumë në gjendje të keqe. Kemi probleme me ujë të pijshëm, nuk kemi ujë mjaftueshëm, po ashtu edhe me kanalizim disa lagje kanë mbetur pa u përfshirë në rrjet, prandaj është mirë që për vitin e ardhshëm të merren parasysh këto kërkesa.

**Muhamed Ramadani, nënkyrytar i fshatit Korroticë e Ulët** – kërkesë primare e fshatit tonë është uji i pijshëm që nuk kemi, jeni në dijeni që gypat janë përcjell e nuk janë funksional, kërkesa është edhe për ndriçim të rrugëve, sidomos ajo afër shkollës që është edhe rrezik i madh për nxënësit e shkollës. Kërkesë e tretë është pastrimi i deponisë në fshatin tonë, që është bërë shumë e rrezikshme dhe kërkohet largimi i saj. Si kryesues i KLSP-së, kërkojë që zyra që e kemi në Komoran të pajiset me inventarin e nevojshëm, në mënyrë që të krijohen kushtet për kryerjen e punëve që kemi, po ashtu përkrahi idenë që të behët Stacioni Policor në Komoran dhe shërbimi i zjarrfikësve.

**Zenel Hyseni, administrator i Komoranit I** – veç u përmend ne këtë dëgjim që Komorani ka nevojë që të këtë Stacionin Policor me objekt dhe të pavarësuar e po ashtu edhe objektin e zjarrfikësve, prandaj është mirë të mendohet kjo çështje që vitin e ardhshëm të jenë këto dy objekte të finalizuara.

**Naim Krasniqi, banorë nga Komoran I** – lokacioni i tregut në Komoran nuk është definuar dhe kërkojë të definohet si vend dhe të jetë më infrastrukturën përcjellëse, asfaltim e trotuar.

**Skender Bogiqi, administrator i Komoranit IV** – kërkesa jonë është për me vazhdu rruga ku ka mbetur në gjysmë, është shumë e nevojshme të asfaltohet ajo pjesë e rrugës, janë afér 300 metra. Po ashtu është mirë që të behët pastrimi i gropës septike. Kemi mungesë të ujit, janë vendosur orët e ujit në ekonomitë familjare, por ujë nuk kemi, prandaj është mirë që kjo çështje të zgjidhet vitin e ardhshëm.

**Kadri Ajazi, administrator i fshatit Sankoc** – kërkesa e parë e fshatit tonë është për trotuar, sepse është shumë e frekuentuar nga nxënësit. Kemi disa lagje që nuk është kryer ende asfaltimi i rrugicave, kemi mungesë të ujit, janë vendosur gypat, por ata nuk janë në funksion. Për rrjetin e kanalizimit kemi nevojë në disa lagje për disa metra që të përfshihen të gjitha lagjet e fshatit. Për vitin e ardhshëm të kryhet kanalizimi dhe të rregullohen dy gropat septike.

**Gazmend Hajdini, administrator i fshatit Zabel i Epërm** – disa lagje të përfshihen për asfaltim të rrugës, lagja Ymeri dhe lagja Hajdini nuk janë kryer ende. Rruga nga lagja e Re e Komoranit është mirë të shtrohet me trotuar që e lidh fshatin tonë sepse është shumë e frekuentuar dhe të ndërtohet një fushë sportive në atë pjesë.

**Fehmi Nishori, nga Komorani III** – kërkojë nga Komuna në këto dëgjime buxhetore që për vitin e ardhshëm të rregullohet trotuari sepse është shumë i nevojshëm.

**Bashkësia Lokale në Drenas** (Drenas I, II dhe III, Poklek i Ri dhe i Vjetër, Vasilevë, Gllobar, lagja e Feronikelit dhe Shtrubullovë) u mbajt me datën 20.08.2020 duke filluar nga ora 14:45 në SHFMU “Rasim Kiqina”



Mbledhjen e hapi, Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun, Bekim Dobra, duke filluar në ora 14:45, ku të pranishëm ishin: Drejtori për Buxhet dhe Financa, Shyqiri Bublaku, Drejtoresha e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, Lumnije Kapi, Drejtoresha për Planifikim Urban dhe

Mbrojtje të Mjedisit, Flutura Avdiu, administratorë të vendbanimeve nga bashkësia e Komoranit dhe përfaqësues të lagjeve.

Fillimisht, Bekim Dobra i përshëndeti të gjithë administratorët e fshatit dhe qytetarët e pranishëm në takim, dhe shpalosi detajet e këtij takimi. Dobra ka njoftuar të pranishmit për rendin e ditës dhe ka treguar rregullat e takimit. Për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia globale COVID-19, takimi është mbajtur në ambient të shkollës “Rasim Kiqina” në Drenas, me përdorimin e maskave dhe mbajtjen e distanvës. Të pranishmit janë pajisur me draft-listën e investimeve kapitale për vendbanimin e tyre dhe janë njoftuar për buxhetin e ndarë për vitet në vazhdim. Të pranishmëve i është paraqitur edhe rendi i ditës së këtij dëgjimi buxhetor;

Rend dite:

7. Informatë e përgjithshme lidhur me buxhetin komunal 2021-2023.
8. Lista e investimeve kapitale në Bashkësinë e Drenosit.
9. Kërkesat e banorëve.

**Bekim Dobra** – ka përshëndetur dhe falënderuar të pranishmit për pjesëmarje, dhe i ka njoftuar për mjetet e qarkores buxhetore për projektet e investimeve kapitale. Ai ka shtuar se për të ju lehtësuar qytetarëve pjesëmarrës ne këto takime, Komuna ka përgatitur listat e investimeve kapitale sipas fshatrave dhe vendbanimeve për të ju lehtësuar debatin pjesëmarrësve.

**Drejtori për Buxhet e Financa, Shyqiri Bublaku** – ka informuar të pranishmit lidhur me draftin e buxhetit të ndarë nga Komuna e Drenosit për vitin 2021 dhe vitet 2022-2023.

**Kërkesat e qytetarëve;**

**Shpend Shala, nga Drenasi I** – kërkojë nga komuna që për vitin e ardhshëm të planifikoj në rregullimin e panelave solare që janë në shesh sepse ka vite që ata nuk janë në funksion. Për vitin e ardhshëm është mirë të rregullohet tregu në Drenas sepse ka mbetur shumë në gjendje të keqe, qe sa vite ende nuk është bërë asnjë investim në atë vend. Qyteti i Drenosit është duke u rrezikuar edhe nga qentë endacak, a ka ndonjë projekt për trajtimin e tyre dhe për largimin e tyre nga qytetit. Për vitin e ardhshëm është mirë që të planifikohet një shteg i çiklizmit në Drenas, sepse në shesh po i rrezikojnë fëmijët ata që po dalin me bicikleta. Po ashtu është mirë të mendohet një rregullim më i mirë i këndit të lodrave, sepse po dëmtohet, me vendos pajisje më të forta të cilat nuk dëmtohen.

**Drejtoresha e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, Lumnije Krapi** – sa i përket trajtimit të qenve endacak, deri më tani ka qenë kompetencë e nivelit qendror trajtimi i tyre, ndërsa tani është në kompetencë të komunave dhe me kodin mallra e shërbime do të behët një zgjidhje e kësaj çështje e cila është problematike jo vetëm në qytet por edhe në fshatra.

**Afrim Lushaku, administrator i lagjes së Feronikelit** – lagja e Feronikelit me rrugë është në gjendje jo të mirë, prandaj për vitin e ardhshëm është mirë të përfshihen rregullimi i rrugëve në lagjen tonë sepse nuk ka pasur asnjë investim në atë pjesë asnjëherë dhe gjenjda e tyre është

shumë e keqe. Po ashtu edhe rrjeti i kanalizimit duhet të rregullohet, prandaj kërkojë që në projekt buxhetin për vitin 2021 të hyjnë këto dy kërkesa me prioritet.

**Afrim Gjeli, administrator i Poklekut të Ri** – Pokleku ka nevojë për ndriçim publik në disa rrugë, sepse është paralogje e qytetit. Rrethoja e varrezave është shumë e nevojshme, po ashtu janë edhe disa metra që kanë nevojë për asfaltim të rrugëve. Në Poklek ka nevojë edhe për rregullimin e trotuarit, po ashtu edhe për një parking për vetura të Palestra e Qytetit “Hysni Jetullahi” dhe të Stadiumi “Rexhep Rexhepi”, sepse kur po zhvillohen ndeshjet sportive komplet banorët e Poklekut po bllokohen nga veturat që po parkohen. Ruga “Nystret Halilaj” është e pa asfaltuar, janë afersisht 1700 metra që kanë nevojë të asfaltohen. Kemi nevojë edhe për rrjetin e kanalizimit që janë 400 metra dhe më rregullimin e kësaj pjese përfshihet i gjithë fshati në rrjetin e kanalizimit. Kemi nevojë edhe për ndriçim publik, shtyllat janë mungon ndriçimi. Të gjitha kërkesat për projektet që kanë nevojë Pokleku i Ri i kam paraqitur edhe me shkrim në drejtoritë përkatëse përmes protokollit.

**Afrim Berisha, administrator nga fshati Vasilevë** – kërkesa jonë është për ujësjellës, nuk kemi ujë dhe ka shumë probleme ne shumicën e fshatit për ujë të pijshëm. Po ashtu kërkesa jonë është edhe për asfaltim të rrugës deri të përmendorja e fshatit.

**Zekë Kluna, administrator nga Pokleku i Vjetër** – kërkojë që t'i behët një zgjidhje ujit të thart, ka mbetur në gjendje tejet të keqe, është mirë që Komuna për vitin e ardhshëm të zgjidh atë problem, ka qenë dikur vendi më i frekuentuar në fshatin tonë, tanë ka mbetur në gjendje të mjerueshme si pasojë e mos kujdesit ndaj asaj burimie natyrore. Kjo ka ardhur si pasojë edhe e rrjetit të kanalizimit që e ka dëmtuar burimin e ujit të thart, prandaj fshati ka nevojë edhe për rregullimin e rrjetit të kanalizimit. Kemi nevojë edhe për asfaltim të rrugës, kanë mbetur edhe disa metra që janë shumë të nevojshme, po ashtu edhe për ndriçim publik në disa rrugë kemi nevojë, prandaj kërkojë që për vitin e ardhshëm të merren parasysh kërkesa tona.

**Nebih Bajraktari, administrator nga Drenasi III (Çikatovë e Re)** – Drenasit III ka nevojë për trotuar në disa pjesë, po ashtu kemi nevojë edhe për 3 rrugë të asfaltohen, janë pak metra, ndërsa rrjeti i kanalizimit duhet të rregullohet, janë bërë bllokime të gropave septike sidomos kur kemi të reshura ujërat e zeza dalin mbi tokë. Në disa rrugë është shumë e nevojshme të behët ndriçimi, të objektet e banimit social gjendja është shumë e rendë, nuk ka park dhe gjelbërim, madje edhe gjendjen me mbeturina e kanë shumë keq. Më së e nevojshme është edhe trotuari dhe rregullimi i kanalizimit e po ashtu edhe shtyllat elektrike të jenë nën tokë, jo mbi tokë, sepse Drenasi III është zonë urbane, jo rurale

Procesmbajtës:

  
Bekim Dobra



Nënkryetari i Komunës

Nazmi Hasi